L I G J
Nr.9548, datë 1.6.2006

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN PËR REGJISTRAT E SHKARKIMIT DHE TË TRANSFERIMIT TË NDOTËSVE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Protokollin për Regjistrat e Shkarkimit dhe të Transferimit të Ndotësve.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4928, datë 16.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

PROTOKOLL
MBI REGJISTRAT E SHKARKIMIT DHE TRANSFERIMIT TË NDOTËSVE I KONVENTËS SË AARHUS MBI TË DREJTËN E INFORMIMIT, PJESËMARRJEN E PUBLIKUT NË VENDIMMARRJE, SI DHE TË DREJTËN E TIJ PËR T'IU DREJTUAR GJYKATËS PËR PROBLEMET MJEDISORE

Palët e këtij Protokolli,

duke kujtuar nenin 5 paragrafi 9 dhe nenin 10 paragrafi 2 të Konventës së vitit 1998 mbi të drejtën e informimit, pjesëmarrjen publike në vendimmarrje dhe drejtësinë lidhur me problemet mjedisore (Konventa Aarhus);

duke ditur se regjistrat e shkarkimit dhe transportimit të ndotësve sigurojnë një mekanizëm të rëndësishëm për rritjen e përgjegjshmërisë së përbashkët, uljen e ndotjes dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm, sikurse thuhet në Deklaratën Lucca të miratuar në takimin e parë të palëve në Konventën Aarhus;

duke pasur parasysh nenin 10 të Deklaratës së Rios të vitit 1992 mbi Mjedisin dhe Zhvillimin;

duke pasur parasysh gjithashtu parimet dhe detyrimet e rëna dakord gjatë Konferencës së Kombeve të Bashkuara të vitit 1992 mbi Mjedisin dhe Zhvillimin, në veçanti dispozitat në kapitullin 19 të agjendës 21;

duke i kushtuar vëmendje programit për zbatimin e mëtejshëm të agjendës 21, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, në sesionin e nëntëmbëdhjetë special të saj në vitin 1997, në të cilën u bë thirrje për nxitje të kapaciteteve dhe aftësive kombëtare në mbledhjen, përpunimin dhe shpërhapjen e informacionit, për mundësimin e së drejtës për t'u informuar mbi çështjet mjedisore nëpërmjet mjeteve të duhura;

duke i kushtuar vëmendje planit të zbatimit të Samitit Botëror të vitit 2002 mbi zhvillimin e qëndrueshëm, i cili mbështet zhvillimin e informacionit bashkëkohor e të integruar mbi elementet kimike, sikurse nëpërmjet regjistrave kombëtare të shkarkimit dhe transportimit të ndotësve;

duke pasur parasysh punën e Forumit Ndërqeveritar mbi Sigurinë e Substancave Kimike, veçanërisht Deklaratën e Bahias të vitit 2002 mbi Sigurinë e Substancave Kimike, Përparësitë e veprimit pas vitit 2000 dhe Regjistrat e Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve/Planin e Veprimit për Inventarin e

Shkarkimeve;

duke pasur parasysh gjithashtu veprimtaritë e ndërmarra në kuadër të Programit Ndërorganizacional për Menaxhimin e Fortë të Substancave Kimike;

duke pasur parasysh për më tepër punën e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, në veçanti Këshillin e Rekomandimit të saj për Vënien në Veprim të Regjistrave të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve, në të cilin Këshilli thërret vendet anëtare të krijojnë dhe të bëjnë të mundur publikisht regjistrat kombëtarë të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve;

duke dashur të sigurohet një mekanizëm i cili do të bëjë të mundur që çdo individ i brezave të sotshëm dhe të ardhshëm të jetojë në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij, duke garantuar progresin e sistemeve të hapura të informacionit mjedisor;

duke dashur gjithashtu të sigurohemi se zhvillimi i këtyre sistemeve merr parasysh parimet, që ndihmojnë një zhvillim të qëndrueshëm, siç është metoda parandaluese e vendosur në parimin 15 të Deklaratës së Rios së vitit 1992 mbi Mjedisin dhe Zhvillimin;

duke ditur lidhjen midis sistemeve adekuate të informacionit mjedisor dhe ushtrimin e të drejtave që përmbahen në Konventën Aarhus;

duke parë nevojën për bashkëpunim me nisma të tjera ndërkombëtare lidhur me ndotjet dhe mbeturinat, duke përfshirë këtu Konventën e Stokholmit të vitit 2001 mbi Mbetjet Organike të Vazhdueshme dhe Konventën e Bazelit të vitit 1989 mbi Kontrollin e Lëvizjeve Transkufitare të Mbetjeve të Rrezikshme dhe Eliminimit të tyre;

duke pranuar se objektivat e një metode të integruar për minimizimin e ndotjes dhe sasisë së mbetjeve, që rezultojnë pas veprimit të instalimeve industriale dhe burimeve të tjera, janë arritja e një niveli të lartë mbrojtjeje të mjedisit në tërësi, ecja drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe të fortë nga pikëpamja mjedisore dhe mbrojtja e shëndetit të brezave të sotëm dhe të ardhshëm;

duke qenë të bindur për vlerën e regjistrave të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve si një mjet me kosto efektive për nxitjen e përmirësimeve në performancën mjedisore, për sigurimin e aksesit publik në informacionin mbi shkarkimin e ndotësve dhe transferimin e tyre në dhe ndërmjet komuniteteve, si dhe për përdorim nga ana e qeverive në ndjekjen e trendeve, shprehjen e progresit në uljen e nivelit të ndotjes, kontrollin e përputhjes me marrëveshje të caktuara ndërkombëtare, vendosjen e përparësive dhe vlerësimin e progresit të arritur përmes politikave dhe programeve mjedisore;

duke marrë parasysh se regjistrat e shkarkimit dhe të transferimit të ndotësve mund të sjellin përfitime të prekshme për industrinë nëpërmjet menaxhimit të përmirësuar të ndotësve;

duke vënë re mundësitë për përdorimin e të dhënave në regjistrat e shkarkimit dhe transferimit të ndotësve, të kombinuar me informacionin shëndetësor, mjedisor, demografik, ekonomik apo të tjera informacione të rëndësishme, me qëllim arritjen e një mirëkuptimi më të mirë të problemeve të mundshme, identifikimin e "pikave të nxehta", marrjen e masave parandaluese dhe shpjeguese dhe vendosjen e përparësive të menaxhimit mjedisor;

duke pranuar rëndësinë e ruajtjes së fshehtësisë së personave fizikë të identifikuar apo të identifikueshëm në përpunimin e informacionit të raportuar në regjistrat e shkarkimit dhe transferimit të ndotësve, në përputhje me standardet e aplikueshme ndërkombëtare lidhur me mbrojtjen e të dhënave;

duke pranuar gjithashtu rëndësinë e zhvillimit të sistemit të regjistrave kombëtarë të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve, të pajtueshëm në nivel ndërkombëtar, për rritjen e krahasueshmërisë së të dhënave;

duke parë se shumë shtete anëtare të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Europën, Komunitetin Europian dhe palët e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Amerikës së Veriut po punojnë për mbledhjen e të dhënave për shkarkimin dhe transferimin e ndotjeve nga burime të ndryshme dhe për t'i bërë ato gjerësisht të mundshme, si dhe duke pranuar veçanërisht për këtë zonë përvojën e gjatë dhe të vlefshme të disa vendeve;

duke marrë në konsideratë përafrime të ndryshme për regjistrat ekzistues të shkarkimit dhe rëndësinë e shmangies së përsëritjeve, duke pranuar në këtë mënyrë nevojën e një shkalle të caktuar fleksibiliteti;

duke nxitur zhvillimin progresiv të regjistrave të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve;

duke nxitur gjithashtu vendosjen e lidhjeve midis regjistrave kombëtare të shkarkimit, dhe transferimit të ndotjeve dhe sistemeve të informacionit mbi të tjera shkarkime të interesit publik,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Objektivi

Objektivi i këtij Protokolli është rritja e mundësisë publike për informacion, nëpërmjet krijimit të regjistrave bashkëkohorë, gjithëpërfshirës dhe kombëtar të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve (PRTR), në përputhje me dispozitat e këtij Protokolli, që do të lehtësojë pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore, si dhe ndihmon në parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllimet e këtij Protokolli,

1. "Palë" nënkupton, veç kur teksti shprehet ndryshe, një shtet ose një organizatë rajonale të integrimit ekonomik të përmendur në nenin 24, që ka rënë dakord të preket nga ky Protokoll dhe në të cilin Protokolli është në fuqi.

2. "Konventë" nënkupton Konventën e të drejtës së informimit, pjesëmarrjes publike në vendimmarrje dhe drejtësisë lidhur me problemet mjedisore, e përgatitur në Aarhus, Danimarkë, në 25 qershor 1998.

3. "Publik" nënkupton një ose më shumë persona fizikë apo juridikë dhe në përputhje me legjislacionin apo praktikën kombëtare, shoqatat, organizatat apo grupet e tyre.

4. "Shërbim" nënkupton një ose më shumë instalime në të njëjtin vend, ose në vendet fqinje, që zotërohen apo punohen nga i njëjti person fizik ose juridik.

5. "Autoriteti kompetent" nënkupton autoritetin apo autoritetet kombëtare, apo ndonjë organ apo organe të tjera kompetente, të ngritura nga një palë për të menaxhuar një sistem të regjistrave kombëtarë të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve.

6. "Ndotës" nënkupton një substancë ose grup substancash, që mund të jenë të dëmshme për mjedisin ose shëndetin e njerëzve, në kurriz të zotërimeve të tij dhe ndikimit të tij në mjedis.

7. "Çlirim" nënkupton çdo futje të ndotësve në mjedis si rezultat i veprimtarisë njerëzore, qoftë e qëllimshme apo jo, e zakonshme apo jo, përfshirë derdhjen, rrezatimin, shkarkimin, futjen, shfrytëzimin apo *dumping*, apo nëpërmjet sistemeve të ujërave të zeza pa trajtimin përfundimtar të mbeturinave ujore.

8. "Transferimi përtej vendit" nënkupton lëvizjen përtej kufijve të burimit të ndotësve dhe mbeturinave të destinuara për shfrytëzim apo përpunim dhe ndotësve në ujin e ndotur të destinuar për trajtim të këtyre ujërave.

9. "Burime të shpërndara" nënkupton burimet e shumta të vogla dhe të përhapura, prej të cilave mund të shkarkohen ndotësit në tokë, ajër apo ujë impakti i kombinuar i të cilëve në këto zëra mund të jetë i rëndësishëm dhe për të cilët nuk është e arsyeshme mbledhja e raporteve nga çdo burim individual;

10. Termat "kombëtar" dhe "gjithëkombëtar" duhet, duke iu referuar detyrimeve nën Protokollin e palëve që janë organizata të integrimit ekonomik, parë sipas vendit në fjalë, veçse kur shprehet ndryshe.

11. "Mbetje" nënkupton substanca apo objekte të cilat:

a) janë hedhur apo përpunuar;

b) do të hidhen apo përpunohen; ose

c) sipas dispozitave të ligjit kombëtar kërkohet të hidhen apo përpunohen;

12. "Mbetje të rrezikshme" do të thotë mbetje të përcaktuara si të rrezikshme nga dispozitat e ligjit kombëtar.

13. "Mbetje të tjera" nënkupton mbetje që nuk janë mbetje të rrezikshme.

14. "Ujë i ndotur" nënkupton ujin që përmban substanca apo objekte që janë subjekt i rregullave të ligjit kombëtar.

Neni 3
Dispozita të përgjithshme

1. Çdo palë duhet të ndërmarrë masat e nevojshme legjislative, rregullatore dhe të tjera dhe masat e duhura zbatuese për të vënë në veprim dispozitat e këtij Protokolli.

2. Dispozitat e këtij Protokolli nuk duhet të prekin të drejtën e një pale për të mirëmbajtur apo paraqitur një regjistër të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve më përfshirës ose me akses më të madh në publik, të kërkuar nga ky Protokoll.

3. Çdo palë duhet të marrë masat e nevojshme, që punonjësit e një shërbimi dhe pjesëtarët e

publikut, që raportojnë një shkelje tek autoritetet publike nga ana e një shërbimi të ligjeve kombëtare, duke zbatuar këtë Protokoll, të mos penalizohen, ndiqen apo shqetësohen nga ky shërbim apo autoritet publike për veprimet e tyre në raportimin e shkeljes.

4. Në zbatimin e këtij Protokolli, çdo palë do të udhëzohet nga metoda parandaluese e caktuar në parimin 15 të Deklaratës së Rios të vitit 1992 mbi Mjedisin dhe Zhvillimin.

5. Për të reduktuar raportimet e përsëritura, sistemet e regjistrit të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve mund të përfshihen në një masë të arsyeshme në burimet ekzistuese të informacionit, siç janë mekanizmat e raportimit sipas licencave ose lejet e veprimit.

6. Palët duhet të përpiqen të arrijnë konvergjencë përgjatë regjistrave kombëtarë të shkarkimit dhe transferimit të ndotjeve.

Neni 4

Elementet kyç të sistemit të regjistrit të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve

Sipas këtij Protokolli, çdo palë duhet të krijojë dhe mirëmbajë një regjistër kombëtar të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve më të mundshëm në publik, i cili:

a) është shërbim specifik përsa i përket raportimit mbi burimet;

b) ndihmon raportimin mbi burimet e shpërndara;

c) është ndotës specifik apo mbetje-specifik, sipas rastit;

d) është multimedia, duke bërë dallimin midis shkarkimeve në ajër, tokë, dhe ujë;

e) përfshin informacion mbi transferimet;

f) bazohet në raportim të detyrueshëm mbi bazë periodike;

g) përfshin të dhëna të standardizuara dhe në afat kohor, një numër të kufizuar pragjesh të standardizuara të raportimit dhe dispozita të kufizuara, nëse ka, për arsye fshehtësie (privacy);

h) është bashkëkohor dhe i hartuar për të qenë përdorues-miqësor dhe publikisht i mundshëm, edhe në formë elektronike;

i) lejon pjesëmarrjen publike në zhvillimin dhe ndryshimin e tij; dhe

j) është një *data base* të dhënash e strukturuar, kompjuterizuar ose *data base* të lidhura të ndryshme, të mbajtura nga autoriteti kompetent.

Neni 5

Hartimi dhe struktura

1. Çdo palë do të sigurojë që të dhënat e zotëruara në regjistër, lidhur me nenin 4, të paraqiten në formularë përmbledhës dhe jo përmbledhës, në mënyrë që shkarkimet dhe transferimet të mund të kërkohen dhe identifikohen sipas:

a) shërbimit dhe vendosjes gjeografike të tij;

b) veprimtarisë;

c) pronarit ose operatorit dhe, kur duhet, kompanisë;

d) ndotësit apo mbetjes, si të jetë e përshtatshme;

e) secilit prej zërave mjedisorë në të cilin shkarkohet ndotësi; dhe

f) sikurse specifikohet në nenin 7 paragrafi 5, destinacionit të transferimit dhe, aty ku duhet, shfrytëzimit apo përpunimit të mbeturinave.

2. Çdo palë duhet të sigurojë gjithashtu që të dhënat të mund të kërkohen dhe identifikohen sipas këtyre burimeve të shpërndara, të përfshira në regjistër.

3. Çdo palë duhet të hartojë regjistrin e saj, duke marrë parasysh mundësinë e zgjerimit të ardhshëm të saj dhe duke siguruar se, të dhënat raportuese, të paktën që prej 10 viteve të fundit të raportimit, të jenë publikisht të mundshme.

4. Regjistri duhet të hartohet për një lehtësi maksimale të aksesit publik nëpërmjet mjeteve elektronike, siç ishte interneti. Hartimi duhet të lejojë që, në kushte normale pune, informacioni i regjistrit të jetë i mundshëm në mënyrë të vazhdueshme dhe të menjëhershme nëpërmjet mjeteve elektronike.

5. Çdo palë duhet të ofrojë lidhje në regjistrin e saj me *data base*-at e duhura ekzistuese dhe publikisht të mundshme, lidhur me çështjet e mbrojtjes së mjedisit.

6. Çdo palë duhet të ofrojë lidhje në regjistrin e saj me regjistrat e shkarkimit dhe transferimit të ndotësve të palëve të tjera në Protokoll dhe, aty ku është e mundur, me ato të vendeve të tjera.

Neni 6

Qëllimi i regjistrit

1. Çdo palë duhet të sigurojë që regjistri i saj të përmbajë informacion mbi:

a) shkarkimet e ndotësve, që duhen raportuar sipas nenit 7 paragrafi 2;

b) transferimet përtej vendit, që duhen raportuar sipas nenit 7 paragrafi 2; dhe

c) shkarkimet e ndotësve nga burimet e shpërndara, sipas nenit 7 paragrafi 4.

2. Duke vlerësuar përvojën e fituar nga hartimi i regjistrave kombëtarë të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve dhe zbatimin e këtij Protokolli dhe duke marrë parasysh procese të rëndësishme ndërkombëtare, takimi i palëve do të rishohë kërkesat raportuese të këtij Protokolli dhe do të konsiderojë çështjet e mëposhtme gjatë zhvillimit të mëtejshëm të tij:

a) Rishikim i veprimtarive të specifikuara në shtojcën I;

b) Rishikim i ndotësve të specifikuar në shtojcën II;

c) Rishikim i pragjeve në shtojcat I dhe II; dhe

d) Përfshirje e aspekteve të tjera të rëndësishme siç është informacioni mbi transferimet në vend, magazinimin, specifikimin e kërkesave raportuese për burimet e shpërndara apo zhvillimin e kriterit për përfshirjen e ndotësve nën këtë Protokoll.

Neni 7

Kërkesat e raportimit

1. Çdo palë duhet gjithashtu:

a) t'i kërkojë zotëruesit ose operatorit të çdo shërbimi individual brenda juridiksionit të tij që të ndërmarrë një ose më shumë nga veprimtaritë e specifikuara në shtojcën 1 mbi pragjet e zbatueshme të kapacitetit, të specifikuar në shtojcën I kolona 1, dhe:

i) të shkarkojë çdo ndotës të specifikuar në shtojcën II në sasi që e kalojnë pragun e zbatueshëm të specifikuar në shtojcën II kolona 1;

ii) të transferojnë përtej vendit çdo ndotës të specifikuar në shtojcën II, në sasi që e kalojnë pragun e zbatueshëm të specifikuar në shtojcën II kolona 2, ku pala ka vendosur për raportim specifik sipas ndotësve të transferimeve në vijim të paragrafit 5(d);

iii) të transferojë përtej vendit mbetje të rrezikshme që kalojnë sasinë 2 ton/vit ose mbetje të tjera, që kalojnë sasinë 2,000 ton/vit, ku pala ka vendosur për raportimin specifik sipas mbetjeve të transferimeve në vijim të paragrafit 5(d); ose

iv) të transferojë përtej vendit çdo ndotës të specifikuar në shtojcën II në ujërat e ndotur të destinuar për trajtimin e tyre, në sasi që kalojnë pragun e zbatueshëm, të specifikuar në shtojcën II kolona 1b;

Të marrë përsipër detyrimin e vënë mbi atë zotërues ose operator në vijim të paragrafit 2; ose

b) të kërkojë zotëruesin ose operatorin e çdo shërbimi individual brenda juridiksionit të tij, që ndërmerr një ose më shumë nga veprimtaritë e specifikuara në shtojcën I, në apo mbi pragun e punësimit të treguar në shtojcën I kolona 2 dhe që prodhon, përpunon apo përdor çdo ndotës të specifikuar në shtojcën II, në sasi që kalojnë pragun e zbatueshëm të treguar në shtojcën II kolona 3, të marrë përsipër detyrimin që i është ngarkuar këtij zotëruesi apo operatori në vijim të paragrafit 2.

2. Çdo palë duhet t'i kërkojë zotëruesit apo operatorit të një shërbimi, të përmendur në paragrafin 1, të paraqesë informacionin e specifikuar në paragrafët 5 dhe 6 dhe në përputhje me kërkesat në to, lidhur me ata ndotës dhe mbetje që kanë kaluar nivelin prag.

3. Në mënyrë që të arrihet objektivi i këtij protokolli, një palë mund të vendosë lidhur me një ndotës të veçantë të zbatojë edhe një prag shkarkimi apo prag prodhimi, përpunimi ose përdorimi, në mënyrë që kjo të rrisë informacionin e lidhur me shkarkimet apo transferimet e pasqyruara në këtë regjistër.

4. Çdo palë duhet të sigurojë që autoriteti kompetent i saj të mbledhë ose të krijojë një ose më shumë autoritete publike apo organe kompetente për të mbledhur informacion mbi shkarkimin e ndotësve nga burimet e shpërndara, të specifikuar në paragrafët 7 dhe 8, për t'u përfshirë në këtë regjistër.

5. Çdo palë duhet t'i kërkojë zotëruesve apo operatorëve të shërbimeve, të raportojnë sipas paragrafit 2 për të përfunduar dhe paraqitur para autoritetit kompetent të saj informacionin e mëposhtëm në baza specifike shërbimi:

a) emri, adresa e rrugës, vendosja gjeografike dhe veprimtaria apo veprimtaritë e shërbimit raportues dhe emrin e zotëruesit ose operatorit dhe, nëse duhet të kompanisë;

b) emri dhe identifikimin numerik të çdo ndotësi, i kërkuar për t'u raportuar në vijim të paragrafit

2;

c) sasinë e çdo ndotësi, për t'u raportuar në vijim të paragrafit 2, të shkarkuar nga shërbimi në mjedis në vitin raportues, në përgjithësi dhe sipas vendit të shkarkimit në ajër, ujë apo tokë, sikurse dhe nga injektimi ndërtokësor;

d) Gjithashtu:

i) sasinë e çdo ndotësi për t'u raportuar në vijim të paragrafit 2 të transferuar përtej vendit në vitin raportues, duke bërë dallim midis sasive të transferuara për shfrytëzim dhe përpunim dhe emrin dhe adresën e shërbimit që e merr këtë transport; ose

ii) sasinë e mbetjeve për t'u raportuar në vijim të paragrafit 2 të transferuar përtej vendit në vitin raportues, duke bërë dallimin midis mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera, për çdo veprim përpunimi apo shfrytëzimi, të treguar respektivisht me "R ose D", nëse mbetjet janë të destinuara për shfrytëzim ose përpunim sipas shtojcës III dhe për lëvizje transkufitare të mbetjeve të rrezikshme, emrin dhe adresën e shfrytëzuesit apo përpunuesit të mbetjeve dhe vendndodhjen aktuale të atyre që presin transferimin;

e) sasia e çdo ndotësi në ujë të ndotur, për t'u raportuar në vijim të paragrafit 2, të transferuar përtej vendit në vitin raportues; dhe

f) llojin e metodologjisë së përdorur për marrjen e informacionit të përmendur në nënparagrafët c) dhe e) të nenit 9 paragrafi 2, që tregojnë nëse informacioni është bazuar në matje, llogaritje, apo vlerësim.

6. Informacioni i përmendur në paragrafin 5 (c) dhe (d) do të përfshijë informacion mbi shkarkimet dhe transferimet, që vijnë si rrjedhojë e veprimtarive të zakonshme dhe prej ngjarjeve të jashtëzakonshme.

7. Çdo palë do të paraqesë në regjistrin e saj, në një hapësirë të veçantë të mjaftueshme, informacion mbi shkarkimet e ndotësve që vijnë nga burimet e shpërndara, për të cilët kjo palë shprehet se të dhënat janë marrë nga autoritetet përkatëse dhe mund të përfshihen në të. Në rastin kur pala arrin në përfundimin se këto të dhëna nuk ekzistojnë, ajo duhet të marrë masa për fillimin e raportimit mbi shkarkimin e ndotësve përkatës nga një apo më shumë burime të shpërndara, në përputhje me përparësitë kombëtare të saj.

8. Informacioni i paraqitur në paragrafin 7 duhet të japë të dhëna mbi llojin e metodologjisë së përdorur për marrjen e informacionit.

Neni 8

Cikli i raportimit

1. Çdo palë duhet të sigurojë se informacioni për t'u përfshirë në këtë regjistër ka akses publik, është i grumbulluar dhe paraqitur në regjistër sipas vitit kalendarik. Viti raportues është viti kalendarik me të cilin lidhet informacioni i dhënë. Për çdo palë, viti i parë i raportimit është ai vit kalendarik pas të cilit hyn në fuqi Protokolli për atë palë. Raportimi i kërkuar sipas nenit 7 duhet të jetë vjetor. Vitit i dytë i raportimit do të ishte viti i dytë kalendarik pas viti të parë të raportimit.

2. Çdo palë, që nuk është një organizatë rajonale e integrimit ekonomik, duhet të sigurojë se informacioni është i përfshirë në regjistrin e saj brenda 15 muajve, që prej fundit të çdo viti raportues. Ndërkohë, informacioni për vitin e parë raportues duhet përfshirë në regjistër brenda dy viteve që prej mbarimit të atij viti raportues.

3. Çdo palë, që është një organizatë rajonale integrimi ekonomik, duhet të sigurojë që informacioni për një vit raportimi specifik të jetë përfshirë në regjistër 6 muaj pasi palëve, që nuk janë organizata rajonale të integrimit ekonomik, u kërkohet të bëjnë të njëjtën gjë.

Neni 9

Mbledhja e të dhënave dhe ruajtja e tyre

1. Çdo palë duhet t'u kërkojë zotëruesve apo operatorëve të shërbimit, që janë subjekt i raportimit sipas nenit 7, të mbledhin të dhëna, të cilat janë të nevojshme për të përcaktuar, në përputhje me paragrafin 2 më poshtë dhe sipas frekuencës përkatëse, shkarkimet e shërbimit dhe transferimet përtej vendit, si subjekt raportimi sipas nenit 7 dhe të bëjë të mundshme për autoritetet kompetente regjistrimet e të dhënave, prej të cilave është marrë informacioni i raportuar për një periudhë prej 5 vjetësh, duke filluar që prej fundit të vitit raportues të interesuar. Këto regjistrime duhet të përshkruajnë gjithashtu metodologjinë e përdorur për mbledhjen e të dhënave.

2. Çdo palë duhet t'u kërkojë zotëruesve apo operatorëve të shërbimit, që janë subjekt i raportimit sipas nenit 7, të përdorin informacionin më të mirë të mundshëm, që mund të përfshijë të dhëna monitoruese, faktorët e emetimit, ekuacionet e ekuilibrit të masave, monitorimin e tërthortë apo llogaritje të tjera, vlerësimet inxhinierike dhe metoda të tjera. Ashtu siç duhet, e gjitha kjo duhet bërë në përputhje me metodologjitë e miratuara ndërkombëtare.

Neni 10
Vlerësimi i cilësisë

1. Çdo palë duhet t'u kërkojë zotëruesve ose operatorëve të shërbimit, që janë subjekt i raportimit sipas nenit 7 paragrafi 1, të sigurojnë cilësinë e informacionit që ata raportojnë.

2. Çdo palë duhet të sigurojë që të dhënat e përfshira në këtë regjistër të jenë subjekt i analizës cilësore nga autoriteti kompetent, në veçanti për plotësinë e tyre, rregullsinë dhe besueshmërinë, duke marrë parasysh çdo udhëzues që mund të hartohet nga takimi i palëve.

Neni 11
E drejta publike në informacion

1. Çdo palë duhet të sigurojë aksesin publik të informacionit të përfshirë në regjistrin e saj të shkarkimit dhe të transferimit të ndotësve, pa nevojën e shprehjes së interesit dhe sipas dispozitave të këtij Protokolli, fillimisht duke garantuar që regjistri i saj të sigurojë akses të drejtpërdrejtë elektronik përmes rrjeteve të telekomunikacionit publik.

2. Në rastet kur informacioni i përfshirë në këtë regjistër nuk është lehtësisht i mundshëm nëpërmjet mjeteve elektronike, çdo palë duhet të sigurojë që autoriteti kompetent i saj, sipas kërkesës, të ofrojë atë informacion nëpërmjet çdo mënyre tjetër efektive, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe të shumtën një muaj pas marrjes së kërkesës.

3. Sipas paragrafit 4, çdo palë duhet të sigurojë që aksesi në informacionin që përmban regjistri i saj të jetë falas.

4. Çdo palë mund të lejojë autoritetin kompetent të saj të vendosë një pagesë për riprodhimin dhe dërgimin e informacionit specifik në vijim të paragrafit 2, por kjo pagesë nuk duhet të kalojë një shumë të caktuar.

5. Në rastet kur informacioni që përmban ky regjistër nuk është lehtësisht i mundshëm nëpërmjet mjeteve të drejtpërdrejta elektronike, çdo palë duhet të lehtësojë mbërritshmërinë elektronike të regjistrit të saj nëpërmjet mjeteve gjerësisht të mundshme, si libraritë publike, zyrat e autoriteteve lokale ose vende të tjera të përshtatshme.

Neni 12
Konfidencialiteti

1. Çdo palë mund të autorizojë autoritetin kompetent të ruajë konfidencialitetin e informacionit të mbajtur në regjistër, nëse transmetimi publik i këtij informacioni do të prekte në të kundërt:

a) marrëdhëniet ndërkombëtare, mbrojtjen kombëtare ose sigurinë publike;

b) drejtësinë, mundësinë e një personi të kishte një gjykim të drejtë ose mundësinë e një autoriteti publik të drejtonte një hetim të natyrës kriminale ose disiplinor;

c) konfidencialitetin e informacionit komercial dhe industrial, në rastet kur ai është i mbrojtur me ligj, në mënyrë që të mbrohet interesi ekonomik legjitim;

d) të drejtat e pronësisë intelektuale; ose

e) konfidencialitetin e të dhënave personale dhe/ose dosjeve të një personi fizik, nëse ky person nuk është dakord me bërjen publike të këtij informacioni, kur ky konfidencialitet sigurohet në ligjin kombëtar.

Bazat e sipërpërmendura për konfidencialitetin duhen interpretuar në mënyrë të kufizuar, duke marrë parasysh interesin publik të cilit i shërben ky transmetim i informacionit dhe nëse informacioni lidhet me shkarkimet në mjedis.

2. Në kuadër të paragrafit 1(c), çdo informacion mbi shkarkimet, i cili është i rëndësishëm për mbrojtjen e mjedisit, duhet zbuluar sipas ligjit kombëtar.

3. Në çdo rast që informacioni mbahet konfidencial sipas paragrafit 1, regjistri duhet të tregojë

llojin e informacionit të mbajtur, përmes p.sh. ofrimit të informacionit të përgjithshëm kimik, nëse është i mundshëm, dhe për çfarë arsyesh është ndërprerë.

Neni 13
Pjesëmarrja publike në hartimin e regjistrave kombëtarë të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve

1. Çdo palë duhet të ofrojë mundësitë e duhura për pjesëmarrjen publike në hartimin e regjistrit të saj kombëtar për shkarkimin dhe transferimin e ndotësve, në kuadër të ligjit kombëtar të saj.

2. Sipas paragrafit 1, çdo palë duhet të ofrojë mundësinë për akses të lirë publik në informacion mbi masat e propozuara lidhur me hartimin e regjistrit kombëtar të saj për shkarkimin dhe transferimin e ndotësve dhe për pranimin e çdo komenti, informacioni, analize apo opinioni, që janë të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes dhe autoriteti përkatës duhet të japë shpjegimin e duhur për këtë input publik.

3. Çdo palë duhet të sigurojë se, kur është ndërmarrë një vendim për të krijuar apo për të ndryshuar rrënjësisht regjistrin e tij, informacioni mbi vendimin dhe konsideratat mbi të cilat ai është bazuar janë bërë publike sipas një kalendari kohor.

Neni 14
Aksesi në drejtësi

1. Çdo palë duhet, në kuadër të legjislacionit kombëtar të saj, të sigurojë se çdo person, që mendon se kërkesa e tij për informacion sipas nenit 11 paragrafi 2 nuk është marrë parasysh, është refuzuar gabimisht, pjesërisht ose plotësisht, nuk është përgjigjur në mënyrë të përshtatshme ose, në të kundërt, nuk është trajtuar sipas dispozitave të këtij paragrafi, të ketë të drejtë të rishikojë procedurën përpara një gjykate ose organi tjetër të pavarur dhe të paanshëm, të krijuara me ligj.

2. Kërkesat në paragrafin 1 nuk kanë anshmëri ndaj të drejtave dhe detyrimeve respektive të palëve nën marrëveshjet ekzistuese të zbatueshme midis tyre dhe që kanë të bëjnë me temën e këtij neni.

Neni 15
Formimi i aftësive

1. Çdo palë duhet të nxisë ndërgjegjësimin publik mbi regjistrin e saj të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve dhe duhet të sigurojë se për akses në regjistrin e saj, si dhe për të kuptuar dhe përdorur informacionin e përfshirë në të, ofrohet ndihmë dhe udhëzim.

2. Çdo palë duhet të ofrojë formim të duhur të aftësive dhe udhëheqjen e duhur drejt autoriteteve dhe organeve përgjegjës në ndihmë të tyre për kryerjen e duhur të detyrave sipas këtij Protokolli.

Neni 16
Bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Palët duhet të bashkëveprojnë dhe të ndihmojnë njëra-tjetrën:

a) Në veprimet ndërkombëtare në ndihmë të objektivave të këtij Protokolli;

b) Në bazë të marrëveshjeve të përbashkëta midis palëve të interesuara, në zbatimin e sistemeve kombëtare në vijim të këtij Protokolli;

c) Në ndarjen e informacionit të këtij Protokolli mbi shkarkimet dhe transferimet brenda zonave kufitare; dhe

d) Në ndarjen e informacionit të këtij Protokolli lidhur me transferimet ndërmjet palëve.

2. Palët duhet të nxisin bashkëpunimin ndërmjet tyre dhe organizatave ndërkombëtare përkatëse, siç përcaktohet, për të nxitur:

a) ndërgjegjësimin publik në nivel ndërkombëtar;

b) transferimin e teknologjisë; dhe

c) ofrimin e asistencës teknike ndaj palëve që janë vende në zhvillim dhe palëve me ekonomi në tranzicion, lidhur me çështjet e këtij Protokolli.

Neni 17

Takimi i palëve

1. Një takim i palëve bëhet në këtë mënyrë. Sesioni i tij i parë duhet thirrur jo më vonë se dy vjet pas hyrjes në fuqi të këtij Protokolli. Që prej këtij momenti, do të mbahen sesione të zakonshme të takimit të palëve në vazhdim ose paralel me takimet e zakonshme të palëve në konventë, përveçse kur vendoset ndryshe nga palët në këtë Protokoll. Takimi i palëve duhet të mbajë një sesion të jashtëzakonshëm nëse vendoset kështu gjatë punës së një sesioni të zakonshëm ose në kërkesën e shkruar të çdo pale duke siguruar që, brenda 6 muajve pas komunikimit të saj te të gjitha palët nga Sekretari Ekzekutiv i Komisionit Ekonomik të Europës, kërkesa e bërë të mbështetet nga të paktën 1/3 e këtyre palëve.

2. Takimi palëve duhet të mbajë nën vëzhgim të vazhdueshëm zbatimin dhe hartimin e këtij Protokolli mbi bazë të një raportimi të rregullt nga ana e palëve dhe duke pasur këtë qëllim parasysh, duhet:

a) të rishohë hartimin e regjistrave të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve dhe të nxisë fuqizimin dhe konvergjencën progresive të tyre;

b) të krijojë udhëzues që të lehtësojnë raportimin e palëve në të, duke mbajtur parasysh nevojën për të shmangur përsëritjen e përpjekjeve në këtë drejtim;

c) të vendosë një program pune;

d) të marrë parasysh dhe, aty ku duhet, të adoptojë masa për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në përputhje me nenin 16;

e) të krijojë aq organe ndihmëse sa të mendojë të nevojshëm;

f) të konsiderojë dhe aprovojë propozime për amendamente të tilla të këtij Protokolli dhe shtojcave të tij, si të shihet e nevojshme për qëllimet e këtij Protokolli, në përputhje me dispozitat e nenit 20;

g) në sesionin e tij të parë, të marrë parasysh dhe me konsensus të vendosë rregullat e procedurës për sesionet e tij dhe ato të organeve ndihmëse të tij, duke marrë parasysh çdo rregull procedure të miratuar nga Takimi i Palëve në Konventë;

h) të vlerësojë krijimin e marrëveshjeve financiare me konsensus dhe mekanizmat e ndihmës teknike për të lehtësuar zbatimin e këtij Protokolli;

i) të kërkojë, aty ku duhet, shërbimet e organeve të tjera përkatëse ndërkombëtare për arritjen e objektivave të këtij Protokolli; dhe

j) të vlerësojë dhe të ndërmarrë ndonjë veprim shtesë që mund të kërkohet për çuarjen përpara të objektivave të këtij Protokolli, sikurse është miratimi udhëzuesve dhe rekomandimeve, që nxisin zbatimin e tij.

3. Takimi palëve duhet të lehtësojë shkëmbimin e informacionit mbi përvojën e fituar në raportimin e transferimeve duke përdorur metodat ndotës-specifik dhe mbetje-specifik dhe duhet të rishohë këtë përvojë, në mënyrë që të hetohet mundësia e konvergjencës midis dy metodave, duke mbajtur parasysh interesin publik për informacion në përputhje me nenin 1 dhe efektivitetin e përgjithshëm të regjistrave kombëtarë të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve.

4. Kombet e Bashkuara, agjencitë e specializuara të tyre dhe Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike, sikurse dhe çdo organizatë shtetërore apo rajonale e integrimit ekonomik, që i është dhënë e drejta sipas nenit 24 për të nënshkruar këtë Protokoll, por që nuk është palë në të dhe çdo organizatë ndërqeveritare e specializuar në fushat në të cilat shtrihet Protokolli, duhet mundësuar të marrë pjesë si vëzhgues në takimin e palëve. E drejta për të hyrë dhe pjesëmarrja duhet t'i nënshtrohet rregullave dhe procedurave të rëna dakord në takimin e palëve.

5. Çdo organizatë joqeveritare e specializuar në fushat e këtij Protokolli, që ka informuar Sekretarin e Përgjithshëm të Komisionit Ekonomik për Europën për dëshirën e saj për t'u përfaqësuar në një sesion të takimit të palëve do të caktohet të marrë pjesë si një vëzhgues, përveçse kur 1/3 e palëve të pranishme në sesion proteston. E drejta për të hyrë dhe pjesëmarrja e tyre do t'i nënshtrohet rregullave procedurale të miratuara nga takimi i palëve.

Neni 18

E drejta për të votuar

1. Me përjashtim të rastit siç tregohet në paragrafin 2, çdo palë e këtij Protokolli do të ketë një votë.

2. Organizatat rajonale për integrim ekonomik, për çështje brenda kompetencës së tyre, do të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës me një numër votash të barabartë me numrin e shteteve anëtare të tyre,

që janë palë. Të tilla organizata nuk do të ushtrojnë të drejtën e votës, nëse shtetet anëtare të tyre e ushtrojnë atë dhe e kundërta.

Neni 19
Shtojcat

Shtojcat e këtij Protokolli do të përbëjnë një formë integrale të tillë dhe derisa qartësisht të parashikohet ndryshe, një referencë ndaj këtij Protokolli përbën në të njëjtën kohë një referencë për çdo shtojcë tjetër.

Neni 20
Amendamentet

1. Çdo palë mund të propozojë amendamente për këtë Protokoll.

2. Propozimet për amendamente në këtë Protokoll duhet të vlerësohen në një sesion të takimit të palëve.

3. Çdo amendament i propozuar për këtë Protokoll duhet dorëzuar me shkrim në sekretariat, i cili duhet ta komunikojë atë të paktën 6 muaj para sesionit në të cilin amendamenti i është propozuar gjithë palëve, shteteve të tjera dhe organizatave rajonale të integrimit ekonomik, të cilat kanë pranuar të jenë pjesë e Protokollit dhe për të cilat nuk ka hyrë ende në fuqi, si dhe pjesëmarrësve.

4. Palët duhet të bëjnë çdo përpjekje për të arritur marrëveshjet mbi çdo amendament të propozuar me konsensus në këtë Protokoll. Nëse janë bërë të gjitha përpjekjet me konsensus dhe nuk është arritur asnjë marrëveshje, amendamenti, si një mundësi e fundit, duhet miratuar me votën e tre të katërtave të palëve të pranishme dhe votuese në sesion.

5. Sipas këtij neni, “Palët e pranishme dhe votuese” do të thotë palët që janë të pranishme dhe që japin një votë pozitive ose negative.

6. Çdo amendament i këtij Protokolli, miratuar në përputhje me paragrafin 4, duhet komunikuar nga ana e Sekretariatit tek depozitari, i cili duhet t’ia qarkullojë atë të gjitha palëve, shteteve dhe organizatave të tjera rajonale të integrimit ekonomik, që kanë pranuar të jenë pjesë e këtij protokolli dhe për të cilat ai s’ka hyrë ende në fuqi, si dhe pjesëmarrësve.

7. Një amendament, një në një shtojcë, duhet të hyjë në fuqi për ato palë që e kanë ratifikuar, pranuar ose miratuar atë në ditën e nëntëmbëdhjetë pas datës së marrjes nga depozitari i ratifikimit, pranimit ose miratimit nga të paktën tre të katërtat e atyre që ishin palë në kohën e adoptimit të tij. Më tej, ai duhet të hyjë në fuqi për çdo palë tjetër në ditën e nëntëmbëdhjetë pas ditës që ajo palë depoziton instrumentet e saj të ratifikimit, pranimit ose miratimit të amendamentit.

Në rastin e një amendamenti në një shtojcë, një palë që nuk e pranon një amendament të tillë duhet të njoftojë depozituesin me shkrim brenda dymbëdhjetë muajve nga data e qarkullimit të tij nga ana e depozituesit. Depozituesit duhet të informojë pa vonesë të gjitha palët për çdo njoftim të marrë të këtij lloji. Një palë mundet të tërheqë në çdo kohë një njoftim të mëparshëm për mospranim e, si pasojë, amendamenti i një shtojce duhet të hyjë në fuqi për atë palë.

9. Me skadimin e dymbëdhjetë muajve nga data e qarkullimit të tij nga ana e depozituesit, siç thuhet në paragrafin 6, një amendament në një shtojcë duhet të hyjë në fuqi për ato palë, të cilat nuk kanë dorëzuar një njoftim te depozituesi sipas paragrafit 8, me kusht që në atë kohë jo më shumë se një e treta e atyre që ishin palë në kohën e adoptimit të amendamentit kanë paraqitur një njoftim të tillë.

10. Nëse një amendament i një shtojce është i lidhur drejtpërsëdrejti me një amendament të këtij Protokolli, ai nuk duhet të hyjë në fuqi derisa amendamenti i këtij Protokolli hyn në fuqi.

Neni 21
Sekretariati

Sekretari Ekzekutiv i Komisionit Ekonomik për Europën duhet të kujdeset për funksionet e mëposhtme sekretariale të këtij Protokolli:

a) Përgatitjen dhe shërbimin e sesioneve të takimit të palëve;

b) Kalimin te palët të raporteve dhe informacioneve të tjera të marra në përputhje me dispozitat e këtij Protokolli;

c) Raportimin në takimin e palëve mbi veprimtaritë e Sekretariatit; dhe

d) Të tjera funksione që mund të përcaktohen nga takimi i palëve në bazë të burimeve të mundshme.

Neni 22
Rishikimi i përputhshmërisë

Në sesionin e tij të parë, takimi i palëve duhet të vendosë me konsensus procedura mbështetëse dhe marrëveshje institucionale të një natyre jogjyqësore, jokontradiktore dhe këshilluese për të vlerësuar dhe nxitur përputhshmërinë me dispozitat e këtij Protokolli dhe të trajtojë rastet e mospërputhjes. Në vendosjen e këtyre procedurave dhe marrëveshjeve, takimi i palëve duhet të marrë parasysh *inter alia*, nëse duhet lejuar marrja e informacionit nga pjesëtarët e publikut mbi çështjet e lidhura me këtë Protokoll.

Neni 23
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Nëse ndodh një mosmarrëveshje midis dy ose më shumë palëve lidhur me interpretimin ose përdorimin e këtij Protokolli, ato duhet të shohin për një zgjidhje përmes negociatave ose mjeti tjetër paqësor për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, të pranueshëm nga ana e palëve në këtë diskutim.

2. Gjatë nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit apo ardhjes në fuqi të këtij Protokolli, apo në çdo kohë të mëpasshme, një shtet mund të deklarojë me shkrim te depozitari se, për një mosmarrëveshje që nuk është zgjidhur në përputhje me paragrafin 1, ai pranon një ose të dy mjetet e mëposhtme për zgjidhjen e debatit, si të detyrueshëm në lidhje me çdo palë që pranon të njëjtin detyrim:

a) Paraqitjen e mosmarrëveshjes para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë;

b) Arbitrazhin në përputhje me procedurën e specifikuar në shtojcën IV.

Një organizatë rajonale e integrimit ekonomik mund të bëjë një deklaratë me efekt të ngjashëm lidhur me arbitrazhin, në përputhje me procedurat e përmendura në paragrafin e mësipërm (b).

3. Nëse palët në diskutim kanë pranuar të dy mjetet për zgjidhjen e mosmarrëveshjes të përmendur në paragrafin 2, mosmarrëveshja mund të paraqitet vetëm para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, veçse nëse palët pjesëmarrëse në debat bien dakord ndryshe.

Neni 24
Nënshkrimi

Ky Protokoll do të nënshkruhet në Kiev (Ukrainë) nga data 21 deri më 23 maj 2003 me rastin e Konferencës së Pestë Ministrore “Mjedis për Europën” dhe më pas në Zyrat Qendrore të Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork deri më 31 dhjetor 2003, nga të gjitha shtetet që janë anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe nga organizatat rajonale për integrim ekonomik, të përbëra nga anëtarë të shteteve sovrane të Kombeve të Bashkuara, te të cilat shtetet anëtare të tyre kanë transferuar kompetencat mbi çështjet e drejtuara nga ky Protokoll, përfshirë dhe kompetencën për të hyrë në tratativa lidhur me këto çështje.

Neni 25
Depozitari

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të veprojë si depozitar i këtij Protokolli.

Neni 26
Ratifikimi, pranimi, miratimi dhe hyrja në fuqi

1. Ky Protokoll do të jetë objekt i ratifikimit, pranimit ose miratimit nga shtetet nënshkruese dhe organizatat rajonale për integrim ekonomik të përmendura në nenin 24.

2. Ky Protokoll do të mund të hyjë në fuqi prej 1 janarit 2004 nga shtetet dhe organizatat rajonale për integrim ekonomik të përmendura në nenin 24.

3. Çdo organizatë rajonale për integrim ekonomik e përmendur në nenin 24, që bëhet palë pa qenë palë asnjë nga shtetet anëtare të saj, do të preket nga gjitha detyrimet e këtij Protokolli. Nëse një apo më shumë shtete anëtare të një organizate të tillë janë palë, organizata dhe shtetet anëtare të saj do të vendosin për përgjegjësitë përkatëse të tyre mbi aftësinë ekzekutuese të detyrimeve të tyre në këtë Protokoll. Në të

tilla raste, organizata dhe shtetet anëtare nuk do të lejohen të ushtrojnë të drejta sipas këtij protokolli në të njëjtën kohë.

4. Në instrumentet e tyre për ratifikim, pranim, aprovim apo hyrje në fuqi, organizatat rajonale për integrim ekonomik të përmendura në nenin 24 duhet të deklarojnë shtrirjen e kompetencës së tyre në lidhje me çështjet e drejtuara nga ky Protokoll. Këto organizata duhet, gjithashtu, të informojnë depozitarin për çdo ndryshim të rëndësishëm mbi shtrirjen e kompetencës së tyre.

Neni 27
Hyrja në fuqi

1. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitës së instrumentit të gjashtëmbëdhjetë për ratifikim, pranim, aprovim, apo ardhje në fuqi.

2. Në bazë të paragrafit 1, çdo instrument i depozituar nga një organizatë rajonale për integrim ekonomik, nuk duhet llogaritur si shtesë në ato të depozituara nga shtetet anëtare të një organizate të tillë.

3. Për çdo shtet apo organizatë rajonale për integrim ekonomik që ratifikon, pranon apo aprovon këtë Protokoll, apo, përveç kësaj bie dakord pas depozitimit të instrumentit të gjashtëmbëdhjetë të ratifikimit, pranimit, miratimit apo ardhjes në fuqi, Protokolli do të hyjë në fuqi ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitës nga ky shtet apo organizatë rajonale për integrim ekonomik të instrumenteve të tij për ratifikim, pranim, aprovim apo ardhje në fuqi.

Neni 28
Rezervat

Asnjë rezervë nuk mund t'i bëhet këtij Protokolli.

Neni 29
Tërheqja

Në çdo moment pas tre vjetësh nga data në të cilën ky Protokoll ka ardhur në fuqi lidhur me një palë, kjo palë mund të tërhiqet nga Protokolli duke bërë një njoftim të shkruar te depozitari. Çdo tërheqje e tillë do të vihet në zbatim në ditën e nëntëdhjetë pas datës së marrjes së tij nga depozitari.

Neni 30
Tekstet autentike

Origjinali i këtij Protokolli, tekstet e të cilit në gjuhën angleze, franceze dhe ruse janë njësoj autentike, do të depozitohen me Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit të autorizuar posaçërisht për këtë kanë firmosur këtë Protokoll.

Bërë në Kiev më 21 maj 2003.

SHTOJCA I

No	Aktiviteti	Pragu i kapacitetit (kolona 1)	Pragu i punësimit (Kolona 2)
1	Sektori i energjetikës		
a)	Rafineritë minerare të vajit dhe gazit	*	
b)	Instalimet për gazifikim dhe lëngëzim	*	10 punonjës
c)	Stacionet e fuqisë termale dhe instalimet e djegies	Me një nxehtësi 50 megavat (MW)	
d)	Furrat e koksit	*	

e)	Mullinjtë e qymyrgurit	Me kapacitet 1 ton/orë	
f)	Instalimet për prodhimin e produkteve të qymyrgurit dhe lëndëve të djegshme të ngurta	*	
2.	Prodhimi dhe përpunimi i metaleve		
a)	Instalimet e xeherorëve (përfshirë sulfidin), pjekjes dhe nxjerrjes së skorieve	*	10 punonjës
b)	Instalimet për prodhimin e kallëpeve të metalit ose çelikut (shkrirje e parë ose e dytë përfshirë derdhjen e vazhdueshme	Me kapacitet 2.5 ton/orë	
c)	Instalimet për përpunimin e metaleve të zeza		
	i) Makinat e petëzimit të nxehtë	Me kapacitet 20 ton çeliku të papërpunuar/orë	
	ii) Kovaçhanat me çekiç	Me energji 50 kiloxhaul për çekiç, ku fuqia kalorifike e përdorur kalon 20 MW	
	iii) Përdorimi i veshjeve mbrojtëse të metaleve të shkrira	Me input 2 ton çeliku të papërpunuar/orë	
d)	Fonderitë e metaleve të zeza	Me kapacitet prodhues 20 ton/ditë	
e)	Instalimet:		
	i) Për prodhimin e metaleve jo të zeza të papërpunuara nga koncentratet ose materialet e papërpunuara dytësore nga proceset metalurgjike, kimike ose elektrolitike	*	
	ii) Për shkrirjen, përfshirë përzierjen, e metaleve jo të zeza, përfshirë produktet e përmirësuara (rafinimin, fonderinë, derdhjen etj.)	Me kapacitete shkrirje prej 4 ton/ditë për plumb dhe kadmium ose 20 ton/ditë për gjithë metalet e tjera	10 punonjës
f)	Instalime për trajtimin e sipërfaqes së metaleve dhe materialeve plastike, duke përdorur proceset elektrolitike ose kimike	Ku vëllimi i kontenierëve të trajtimit është 30 m^3	
3.	Industria minerare		10 punonjës
a)	Punimi minerar nëntokësor dhe veprimet e ndërlidhura me të	*	
b)	Miniera të hapura	Ku sipërfaqja e zonës së gërmuar është 25	

		hektar	
c)	Instalimet për prodhimin e:		
	i) Mbetjet e çimentos në furrat rrotulluese	Me një kapacitet prodhimi 500 ton/ditë	
	ii) Gëlqeres në furrat rrotulluese	Me një kapacitet prodhimi që kalon 50 ton/ditë	
	iii) Mbetjet e çimentos dhe gëlqeres në furrat rrotulluese	Me një kapacitet prodhimi prej 50 ton/ditë	
d)	Instalimet për prodhimin e asbestos dhe manifakturimin e produkteve me bazë asbestoje	*	
e)	Instalimet për prodhimin e qelqit, përfshirë fibrat e qelqit	Me një kapacitet shkrirjeje prej 20 ton/ditë	
f)	Instalimet për shkrirjen e substancave minerare, përfshirë prodhimin e fibrave minerare	Me një kapacitet shkrirjeje prej 20 ton/ditë	
g)	Instalimet për prodhimin e produkteve qeramike përmes pjekjes, në veçanti,të tjegullave e të çative, tullave, tullave zjarrduruese, tjegullave, gresit ose porcelanit	Me një kapacitet prodhimi prej 75 ton/ditë ose një kapacitet pjekjeje prej 4 m^3 dhe me densitet vendosjeje për furrë prej 300 kg/m^3	
4.	Industria kimike		
a)	Instalimet kimike për prodhimin e një shkalle industriale të produkteve kimike organike bazë, të tillë si: i) Hidrokarburet e thjeshtë (linearë ose ciklikë, të ngopur ose të pangopur, alifatik ose aromatik) ii) Hidrokarburet me përmbajtje oksigjeni si, alkooli, aldehidet, ketonet, acidet karboksilike, esteri, eteri, peroksidet, epoksi rezinat iii) Hidrokarbonet sulfurike	*	10 punonjës
	iv) Hirdokarbonet nitrogjene, si aminet, amidet, përbërjet nitrike apo përbërjet e nitratit, nitrilet, cianatet, izocianatet v) Hidrokarbonet me përmbajtje fosfori vi) Hidrokarbonet halogjenike vii) Përbërjet organometalike viii) Materialet plastike bazë (polimeret, fibrat sintetike dhe fibrat me bazë celuloze) ix) Gomat sintetike x) Ngjyrimet dhe pigmentet		10 punonjës

	xi) Agjentët aktivë sipërfaqësorë dhe veshjet sipërfaqësore		
b)	Instalimet kimike për prodhimin e një shkalle industriale të produkteve kimike inorganike bazë si: i) gazrat, si amoniak, klor ose klorur hidrogjeni. Oksidet e karbonit, përbërjet sulfurike, oksidet e nitrogjenit, hidrogjen, dyoksid sulfuri, klor karboni. ii) Acidet, të tilla si acidi kromik, acidi hidroflurik, acid fosforik, acid nitrik, acid hidroklorik, acid sulfurik, oleum, acidet sulfurike iii) Bazat të tilla si hidroksid amoni, hidroksid potasiumi, hidroksid sodiumi iv) kripërat, të tilla si klorid amoni, klorat potasiumi, karbonat potasiumi, karbonat sodiumi, nitrat argjendi v) Jometalet, oksidet metalike ose përbërje të tjera inorganike, të tilla, si karbit kalciumi, silikon, karbit silikoni	*	
c)	Instalimet kimike për prodhimin e një shkalle industriale të fertilizuesve me bazë fosfori, nitrogjeni ose potasiumi (fertilizues të thjeshtë ose të përbërë)	*	
d)	Instalimet kimike për prodhimin e një shkalle industriale të produkteve bimore bazë dhe të biocideve	*	
e)	Instalimet që përdorin një proces kimik ose biologjik për prodhimin e një niveli industrial të produkteve bazë farmaceutike	*	
f)	Instalimet për prodhimin në një shkallë industriale të eksplozivëve dhe produkteve piroteknike	*	10 punonjës
5.	Menaxhimi i mbeturinave dhe i ujërave të ndotur		
a)	Instalimet për djegien, pirolizën, përpunimin, trajtimin kimik apo groposjen e mbetjeve të rrezikshme	Marrin 10 ton/ditë	
b)	Instalimet për djegien e mbeturinave bashkiake	Me një kapacitet prej 3 ton/orë	
c)	Instalimet për pastrimin e mbetjeve jo të rrezikshme	Me një kapacitet prej 50 ton/ditë	
d)	Groposjet (duke përjashtuar groposjet e mbeturinave inerte)	Marrin 10 ton/ditë ose me një kapacitet total	

		prej 25 000 ton	
e)	Instalimet për pastrimin ose riciklimin e trupave të kafshëve apo mbeturinave shtazore	Me një kapacitet trajtimi prej 10 ton/ditë	
f)	Fabrikat e trajtimit të ujërave të ndotur në nivel bashkie	Me një kapacitet korrespondues prej 100 000 banorësh	10 punonjës
g)	Impiantet e pavarura të trajtimit të ujërave të ndotura industriale që i shërbejnë një ose disa aktiviteteve të këtij aneksi	Me një kapacitet prej 10 000 m^3/ditë	
6.	Prodhimi dhe përpunimi i letrës dhe i drurit		
a)	Fabrikat industriale për prodhimin e brumit të letrës prej lëndës drusore ose materialeve të ngjashme fibroze	*	
b)	Fabrikat industriale për prodhimin e letrës dhe dërrasës dhe produkteve të tjera parësore drusore (të tilla si tabela dërrase, dërrasa fibre dhe kompensatë)	Me një kapacitet prodhimi prej 20 ton/ditë	10 punonjës
c)	Fabrikat industriale për ruajtjen e drurit dhe produkteve drusore me produkte kimike	Me një kapacitet prodhimi prej 50 m^3/ditë	
7.	Prodhimi intensiv blegtoral dhe kulturës ujore		
a)	Instalimet për rritjen intensive të shpendëve dhe derrave	i) Me 40 000 vende për shpendët ii) Me 2 000 vende për prodhimin e derrave (mbi 30 kg) iii)Me 750 vende për dosa	10 punonjës
b)	Kultura ujore intensive	1 000 ton peshq dhe molusqe në vit	10 punonjës
8.	Produkte shtazore dhe bimore nga sektori i ushqimeve dhe pijeve		
a)	Thertoret	Me një kapacitet të prodhimit të mishit të therur prej 50 ton/ditë	
b)	Trajtimi dhe përpunimi për prodhimin e produkteve ushqimore dhe pijeve nga:		10 punonjës
	i) materialet e papërpunuara shtazore (përveç qumështit)	Me një kapacitet prodhimi produkti përfundimtar prej 75 ton/ditë	
	ii) Materialet e papërpunuara bimore	Me një kapacitet prodhimi produkti përfundimtar prej 300 ton/ditë (vlerë mesatare në bazë	

		tremujore)	
c)	Trajtimi dhe përpunimi i qumështit	Me një kapacitet marrjeje prej 200 ton qumësht/ditë (vlerë mesatare mbi bazë vjetore)	
9.	Veprimtari të tjera		
a)	Fabrika për paratrajtimin (veprime të tilla si larja, çngjyrosja) ose ngjyrosja e fibrave dhe tekstileve	Me një kapacitet trajtimi prej 10 ton/ditë	
b)	Fabrika për regjjen e gëzofëve dhe lëkurëve	Me një kapacitet trajtimi prej 12 ton produkti përfundimtar/ditë	
c)	Instalimet për trajtimin e sipërfaqes së substancave, objekteve apo produkteve duke përdorur tretës organikë, veçanërisht për veshje, publikim, mbulesë, çlubrifikim, mbrojtjen nga uji, formatimin, lyerjen, pastrimin	Me një kapacitet konsumi prej 150 kg/orë ose 200 ton/vit	10 punonjës
d)	Instalimet për prodhimin e karbonit (qymyrguri i djegur fort) ose elektrografitë nëpërmjet djegies ose grafitizimit	*	
e)	Instalimet për ndërtimin e anijeve dhe lyerjen ose heqjen e bojës prej tyre	Me një kapacitet për anije 100 m të gjata	

Shënime shpjeguese

Kolona 1 përmban pragjet e kapacitetit të treguar në nenin 7 paragrafi 1 (a).

Një asterisk (*) tregon që nuk ka prag kapaciteti të aplikueshëm (të gjitha shërbimet janë subjekt i raportimit).

Kolona 2 përmban pragun e punësimit të treguar në nenin 7 paragrafi 1(b).

“10 punonjës” nënkupton ekuivalentin e 10 punonjësve të punësuar me kohë të plotë.

SHTOJCA II
NDOTËSIT

Nr.	Nr.CAS	Ndotësi	Pragu i shkarkimeve (kolona 1)			Kufiri për transferimin jashtë impiantit ndotësve (Kolona 2) kg/vit	Pragu i prodhimit, përpunimit apo përdorimit (kolona 3) kg/vit
			Në ajër (kolona 1a) kg/vit	Në ujë (Kolona 1b) kg/vit	Në tokë (Kolona 1c) kg/vit		
1	74-82-8	Metan (CH4)	100 000	-	-	-	*

2	630-08-0	Monoksid karboni (CO)	500 000	-	-	-	*
3	124-38-9	Dyoksid karboni (CO_2)	100 milion	-	-	-	*
4		Hidro-fluorokarbonet (HFCs)	100	-	-	-	*
5	10024-97-2	Oksid azoti (N_2))	10 000	-	-	-	*
6	7664-41-7	Amoniak (NH_3)	10 000	-	-	-	10 000
7	-	Përbërjet organike të avullueshme pa metan (NMVOC)	100 000	-	-	-	*
8		Oksidet e nitrogjenit (NO_x/NO_2)	100 000	-	-	-	*
9		Perfluorokarbonet (PFCs)	100	-	-	-	*
10	2551-62-4	Heksafluoridi sulfurit (SF_6)	50	-	-	-	*
11		Oksid sulfuri ($S0_x/SO_2$)	150 000	-	-	-	*
12		Nitrogjen total	-	50 000	50 000	10 000	10 000
13		Fosfor Total	-	5 000	5 000	10 000	10 000
14		Hidroklorofluorokarbonet ($HCFC_s$)	1	-	-	100	10 000
15		Kloroflurokarbonet (CFC_s)	1	-	-	100	10 000
16		Halons	1	-	-	100	10 000
17	7440-38-2	Arsenik dhe përbërjet (si As)	20	5	5	50	50
18	7440-43-9	Kadmium dhe përbërjet (si Cd)	10	5	5	5	5
19	7440-47-3	Kromi dhe përbërjet (si Cr)	100	50	50	200	10 000
20	7440-50-8	Bakër dhe përbërjet (si Cu)	100	50	50	500	10 000
21	7439-97-6	Mërkuri dhe përbërjet (si Hg)	10	1	1	5	5
22	7440-02-0	Nikel dhe përbërjet (si Ni)	50	20	20	500	10 000
23	7439-92-1	Plumbi dhe përbërjet (si Pb)	200	20	20	50	50
24	7440-66-6	Zink dhe përbërjet (si Zn)	200	100	100	1 000	10 000
25	15972-60-8	Alaklor	-	1	1	5	10 000
26	309-00-2	Aldrin	1	1	1	1	1
27	1912-24-9	Atrazine	-	1	1	5	10 000
28	57-74-9	Klordan	1	1	1	1	1
29	143-50-0	Klordekon	1	1	1	1	1
30	470-90-6	Klorfenvin	-	1	1	5	10 000
31	85535-84-8	Kloro-alkanet, C_{10}-C_{13}	-	1	1	10	10 000
32	2921-88-2	Klorpirif	-	1	1	5	10 000
33	50-29-3	DDT	1	1	1	1	1

34	107-06-2	1,2-dikloretan (EDC)	1 000	10	10	100	10 000
35	75-09-2	Diklorometane (DCM)	1 000	10	10	100	10 000
36	60-57-1	Dieldrin	1	1	1	1	1
37	330-54-1	Diuron	-	1	1	5	10 000
38	115-29-7	Endosulfan	-	1	1	5	10 000
39	72-20-8	Endrin	1	1	1	1	1
40		Përbërjet organike halogjene (si AOX)	-	1 000	1 000	1 000	10 000
41	76-44-8	Heptaklor	1	1	1	1	1
42	118-74-1	Heksaklorobenzen (HCB)	10	1	1	1	5
43	87-68-3	Heksaklorobutadin (HCBD)	-	1	1	5	10 000
44	608-73-1	1,2,3,4,5,6-heksaklorocikloheksan (HCH)	10	1	1	1	10
45	58-89-9	Lindan	1	1	1	1	1
46	2385-85-5	Mireks	1	1	1	1	1
47		PCDD+PCDF (dioksina+furane) (si Teq)	0.001	0.001	0.001	0.001	0.001
48	608-93-5	Pentaklorobenzen	1	1	1	5	50
49	87-86-5	Pentaklorofenol (PCP)	10	1	1	5	10 000
50	1336-36-3	Bifenilet e poliklorinuara (PCBs)	0.1	0.1	0.1	1	50
51	122-34-9	Simazin	-	1	1	5	10 000
52	127-18-4	Tetrakloroetilen (PER)	2 000	-	-	1 000	10 000
53	56-23-5	Tetraklorometan (TCM)	100	-	-	1 000	10 000
54	12002-48-1	Triklorobenzen (TCBs)	10	-	-	1 000	10 000
55	71-55-6	1,1,1-trikloroetan	100	-	-	1 000	10 000
56	79-34-5	1,1,2,2-tetrakloroetane	50	-	-	1 000	10 000
57	79-01-6	Trikloroetilen	2 000	-	-	1 000	10 000
58	67-66-3	Triklorometan	500	-	-	1 000	10 000
59	8001-35-2	Toksafen	1	1	1	1	1
60	75-01-4	Vinil kloridi	1 000	10	10	100	10 000
61	120-12-7	Antracen	50	1	1	50	50
62	71-43-2	Benzen	1 000	200 (si BTEX)[a/]	200 (si BTEX)[a/]	2000 (si BTEX)[a/]	10 000
63		Difenil eteret e bromuara (PBDE)	-	1	1	5	10 000
64		Nonifenol etoksilatet (NP/NPEs) dhe substancat e ngjashme	-	1	1	5	10 000
65	100-41-4	Etil benzen	-	200 (si BTEX)[a/]	200 (si BTEX)[a/]	2000 (si BTEX)[a/]	10 000
66	75-21-8	Oksid etilen	1 000	10	10	100	10 000
67	34123-59-6	Izoproturon	-	1	1	5	10 000
68	91-20-3	Nafthalin	100	10	10	100	10 000
69		Përbërjet organotin (si total Sn)	-	50	50	50	10 000

70	117-81-7	Dy-(2-etil eksil)ftalate (DEHP)	10	1	1	100	10 000
71	108-95-2	Fenol 9(si total C)	-	20	20	200	10 000
72		Hidrokarbonet aromatike policiklike (PAHs)[b]	50	5	5	50	50
73	108-88-3	Toluen	-	200 (si BTEX)[a/]	200 (si BTEX)[a/]	2000 (si BTEX)[a/]	10 000
74		Tributitin dhe përbërjet	-	1	1	5	10 000
75		Trifeniltin dhe përbërjet	-	1	1	5	10 000
76		Karbon organik total (TOC) (si total C ose COD/3)	-	50 000	-	-	**
77	1582-09-8	Trifluralin	-	1	1	5	10 000
78	1330-20-7	Ksilen	-	200 (si BTEX)[a/]	200 (si BTEX)[a/]	2000 (si BTEX)[a/]	10 000
79		Kloridet (si total Cl)	-	2 milion	2 milion	2 milion	10 000[c]
80		Klori dhe përbëhet inorganike (si HCl)	10 000	-	-	-	10 000
81	1332-21-4	Asbest	1	1	1	10	10 000
82		Cianidet (si total CN)	-	50	50	500	10 000
83		Fluoridet (si total F)	-	2 000	2 000	10 000	10 000[c]
84		Fluori dhe përbërjet inorganike (si HF)	5 000	-	-	-	10 000
85	74-90-8	Hidrogjen cianid (HCN)	200	-	-	-	10 000
86		Lënda e grimcuar pezull (PM10)	50 000	-	-	-	*

Shënime shpjeguese

Numri CAS i ndotësve nënkupton identifikuesin e saktë në shërbimin abstrakt të kimikateve (Chemical Abstracts Servive).

Kolona 1 përmban pragjet e përmendura në nenin 7 paragrafi 1(a)(i) dhe (iv). Nëse kalohet pragu në një nënkolonë (ajër, ujë, tokë), kërkohet raportimi i shkarkimeve ose, për ndotësit në ujërat e ndotura të destinuara për trajtimin e këtyre të fundit, transferimeve në hapësirat mjedisore të përmendura në atë nënkolonë, lidhur me shërbimin në fjalë për ato palë që kanë zgjedhur një sistem raportimi në vijim të nenit 7 paragrafi 1(a).

Kolona 2 përmban pragjet e treguara në nenin 7 paragrafi 1(a)(ii). Nëse pragu për një ndotës të dhënë në këtë kolonë është kaluar, kërkohet raportimi i transferimeve jashtë impiantit të këtij ndotësi lidhur me shërbimin në fjalë, për ato palë që kanë zgjedhur një sistem raportimi në vijim të nenit 7 paragrafi 1 (a)(ii).

Kolona 3 përmban pragjet e treguara në nenin 7 paragrafi 1(b). Nëse pragu për një ndotës të dhënë në këtë kolonë është kapërcyer, kërkohet raportimi i shkarkimeve dhe transferimeve jashtë impiantit të këtij ndotësi lidhur me shërbimin në fjalë, për ato palë që kanë zgjedhur një sistem raportimi në vijim të nenit 7 paragrafi 1 (b).

Një shenjë minus (-) tregon që parametri në fjalë nuk plotëson një kërkesë raportimi.

Një asterisk (*) tregon se, për këtë ndotës, pragu i shkarkimit në kolonën (i)(a) duhet përdorur para pragut të prodhimit, përpunimit apo përdorimit.

Një asterisk i dyfishtë (**) tregon se, për këtë ndotës, pragu i shkarkimit në kolonën (1)(b) duhet përdorur para pragut të prodhimit, përpunimit apo përdorimit.

Shënime.

a) Ndotësit e veçantë duhen përdorur nëse është kapërcyer pragu për BTEX (parametri shumë i benzenit, toluenit, etil benzenit, ksilenit).

b) Hidrokarbonet aromatike policiklike (PAHs) duhen matur si benzo(a)pirene (50-32-8), benzo(b)fluorantene (205-92-2), benzo(k)fluorantene (207-08-9), indeno (1,2,3-cd) pyrene (193-39-5) (të derivuara nga Protokolli për ndotësit organikë të qëndrueshëm të Konventës së Ndotjes së Ajrit në distanca të mëdha ndërkufitare).

c) Si përbërje inorganike.

SHTOJCA III
PJESA A

Operacionet asgjësuese (‘D’)

- Depozitimi në brendësi ose në sipërfaqe të tokës (p.sh. groposja).
- Trajtimi i tokës (p.sh. biodergradimi i hedhjeve likuide ose ndotëse në tokë).
- Injektimi i thellë (p.sh. injektimi i hedhjeve të rrjedhshme në puse, gropa të krijuara nga depozitime natyrale).
- Zotërimi i sipërfaqeve (p.sh. vendosja e hedhurinave likuide ose të ndotura në gropa të thella, liqene të vogla ose laguna).
- Landfille (venddepozitime)inxhinierike speciale (p.sh. vendosja në qeliza të veçanta të renditura të izoluara nga njëra-tjetra dhe nga mjedisi).
- Shkarkimi në një pjesë ujore përveç deteve/oqeaneve.
- Shkarkimi në dete/oqeane përfshirë futjen në shtratin detar.
- Trajtimi fiziko-kimik i paspecifikuar në këtë shtojcë, i cili rezulton në përbërje ose përzierje përfundimtare, të cilat shkarkohen nëpërmjet mjeteve të ndonjë prej operacioneve të specifikuara në këtë pjesë.
- Trajtimi fiziko-kimik i paspecifikuar në këtë shtojcë, i cili rezulton në përbërje ose përzierje përfundimtare, që shkarkohen nëpërmjet mjeteve të ndonjë operacioni të specifikuar në këtë pjesë (p.sh. avullimi, tharja, kalcifikimi, neutralizimi, precipitimi).

- Djegia në tokë.
- Djegia në det.
- Magazinimi i përkohshëm p.sh. vendosje e konteinerëve në minierë.
- Përzierja përpara dorëzimit në ndonjë nga operacionet e specifikuara në këtë pjesë.
- Ripaketimi para dorëzimit në ndonjë nga operacionet e specifikuara në këtë pjesë.
- Magazinimi gjatë ndonjë nga operacionet e specifikuara në këtë pjesë.

PJESA B
OPERACIONET RIKUPERUESE (‘R’)

- Përdorimi si naftë (dhe jo në djegie të drejtpërdrejtë) ose mjete të tjera për gjenerimin e energjisë.
- Riciklimi/rigjenerimi i substancave organike, që nuk përdoren si tretës.
- Riciklimi/rigjenerimi i metaleve dhe përbërjeve metalore.
- Riciklimi/rigjenerimi i materialeve të tjera inorganike.
- Rigjenerimi i acideve ose bazave.
- Përpunimi i përbërësve të përdorur për uljen e ndotjes.
- Përpunimi i përbërësve nga katalizatorët.
- Rirafinimi i vajit të përdorur ose të tjera ripërdorime të vajit të përdorur më parë.
- Trajtimi i tokës në favor të bujqësisë ose përmirësimit ekologjik
- Përdorimi i materialeve të mbetura të marra nga ndonjë prej operacioneve të përpunimit të specifikuar më lart në këtë pjesë.
- Shkëmbimi i mbeturinave për t’u dorëzuar në ndonjë prej operacioneve të përpunimit të specifikuara më lart në këtë pjesë.
- Akumulimi i materialeve të synuar për ndonjë nga operacionet e specifikuara në këtë pjesë.

SHTOJCA IV
ARBITRAZHI

1. Në kuadrin e një diskutimi të bërë për arbitrazhin në vijim të nenit 23 paragrafi 2 të këtij Protokolli, një palë apo palët do të njoftojë palën apo palët e tjera në diskutim përmes mjeteve diplomatike,

sikurse dhe sekretariatin, për çështjen e arbitrazhit dhe të tregojnë, në veçanti, nenet e këtij Protokolli, interpretimi dhe përdorimi i të cilëve i takojnë kësaj çështjeje. Sekretariati do t'ua kalojë informacionin e marrë të gjitha palëve të këtij Protokolli.

2. Gjykata arbitrare do të përbëhet nga 3 anëtarë. Pala apo palët pretenduese dhe pala apo palët e tjera në diskutim do të caktojnë një gjykatës dhe të dy gjykatësit e zgjedhur në këtë mënyrë do të zgjedhin përmes një marrëveshjeje të përbashkët gjykatësin e tretë, i cili do të jetë presidenti i gjykatës arbitrare. Ky i fundit nuk duhet të jetë bashkëkombës i ndonjë prej palëve në diskutim, nuk duhet të jetë rezident në territorin e ndonjë prej këtyre palëve, nuk duhet të jetë i punësuar prej ndonjërës prej tyre, si dhe nuk duhet të jetë marrë me këtë çështje në ndonjë funksion tjetër.

3. Nëse presidenti i gjykatës arbitrare nuk është përcaktuar brenda dy muajsh pas zgjedhjes së gjykatësit të dytë, Sekretari Ekzekutiv i Komisionit Ekonomik për Europën do të caktojë presidentin, me kërkesën e çdo pale në diskutim, brenda një periudhe të mëpasshme dy mujore.

4. Nëse një nga palët në diskutim nuk përcakton një gjyqtar brenda dy muajve të lajmërimit të përmendur në paragrafin 1, Pala tjetër mund të informojë në këtë mënyrë Sekretarin Ekzekutiv të Komisionit Ekonomik për Europën, i cili do të zgjedhë presidentin e gjykatës arbitrare brenda një periudhe të mëpasshme dymujore. Pas zgjedhjes, presidenti i gjykatës arbitrare do t'i kërkojë palës që nuk ka caktuar një gjyqtar, ta bëjë këtë gjë brenda dy muajve. Nëse kjo palë nuk arrin ta bëjë këtë brenda kësaj periudhe, atëherë Presidenti do të informojë Sekretarin Ekzekutiv të Komisionit Ekonomik për Europën, i cili do e bëjë këtë emërim në dy muajt e mëpasshëm.

5. Gjykata arbitrare duhet t'i marrë vendimet e saj në përputhje me ligjin ndërkombëtar dhe dispozitat e këtij Protokolli.

6. Çdo gjykatë arbitrare e krijuar sipas dispozitave të vendosura në këtë shtojcë, do të përgatisë rregullat e saj personale të procedurës.

7. Vendimet e gjykatës arbitrare, si në procedurë dhe në temë, do të merren me shumicën e votave të anëtarëve të saj.

8. Gjykata mund të marrë të gjitha masat e duhura për verifikimin e fakteve.

9. Palët në diskutim duhet të lehtësojnë punën e gjykatës arbitrare, dhe në veçanti, duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion të tyre, duhet:

a) T'i sigurojnë asaj gjithë dokumentet, lehtësirat dhe informacionin e nevojshëm;

b) Ta mundësojë atë, kur është e nevojshme, të thërrasë dëshmitarë ose ekspertë dhe të marrë evidencat e tyre.

10. Palët dhe gjyqtarët duhet të ruajnë fshehtësinë e çdo informacioni që ata marrin në mirëbesim gjatë ecurisë së gjyqit arbitrar.

11. Gjykata arbitrare mund, me kërkesën e njërës prej palëve, të rekomandojë masa të brendshme mbrojtjeje.

12. Nëse njëra nga palët në diskutim nuk paraqitet para gjykatës arbitrare apo dështon në mbrojtjen e çështjes së saj, Pala tjetër mund t'i kërkojë gjykatës të vazhdojë punimet dhe të japë vendimin përfundimtar të saj. Mungesa e një pale ose dështimi i saj në mbrojtjen e çështjes nuk do të përbëjë një pengesë për punimet. Para marrjes së vendimit përfundimtar, gjykata arbitrare duhet të mbetet e kënaqur në vetvete për gjetjen e drejtë të akuzës, bazuar në fakt dhe ligj.

13. Gjykata arbitrare mund të dëgjojë dhe përcaktojë kundërakuzat që vijnë drejtpërdrejt prej temës së diskutimit.

14. Derisa gjykata arbitrare vendos të kundërtën, si pasojë e rrethanave të veçanta të çështjes, shpenzimet e gjyqit, përfshirë pagesën e anëtarëve të saj, do të mbahen nga palët në diskutim në pjesë të barabarta. Gjyqi duhet të mbajë një dokument me të gjitha shpenzimet e tij dhe duhet t'u dorëzojë një gjendje përfundimtare të tij palëve.

15. Çdo palë e këtij Protokolli, që ka interes të një natyre ligjore në çështjen e diskutimit dhe që mund të preket nga një vendim i çështjes, mund të ndërhyjë në punimet e seancës me pëlqimin e gjyqit.

16. Gjykata arbitrare duhet të japë verdiktin e saj brenda 5 muajve pas datës së krijimit, derisa ajo e sheh të nevojshme shtrirjen e afatit përfundimtar për një periudhë, që nuk i kalon 5 muaj.

17. Verdikti i gjykatës arbitrare duhet të shoqërohet me një deklarim të arsyeve. Ai duhet të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm për çdo palë pjesëmarrëse në diskutim. Verdikti do t'u transmetohet palëve në diskutim dhe sekretariatit. Sekretariati do t'ua transmetojë informacionin e marrë të gjithë palëve të këtij Protokolli.

18. Çdo diskutim që mund të ndodhë midis palëve, lidhur me interpretimin ose zbatimin e vendimit, mund t'i paraqitet nga çdo Palë gjykatës arbitrare, që mori vendimin, ose, nëse kjo e fundit nuk

mund të bëjë kontrollin e këtij fakti, një gjykate tjetër të krijuar për këtë qëllim, në të njëjtën mënyrë si e para.